

»NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN



STATUT

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
(LIMITED LIABILITY COMPANY)**

»NEO & QUALITY« L.L.C. PRIZREN

PRIZREN - 19.12.2016



Në bazë të kërkesave nga neni 33, 83 dhe 85 të Ligjit, Nr.02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, dispozitave të Ligjit, Nr.04/L-006 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Bazik Për Shoqëritë Tregtare, si dhe duke u bazuar në Vendimin dhe Marrëveshjen tonë për Themelimin dhe Konstituimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, të datës 19.12.2016. Në cilësinë e themeluesve vendosëm, duke rrezikuar kapitalet vetanake, e me qëllim të realizimit të fitimit mbi bazat ligjore të legjislacionit të Republikës së Kosovës. Më datën 19.12.2016, unanimisht nxjerrim dhe aprovojmë këtë:

STATUT

TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUA - LIMITED LIABILITY COMPANY
» NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, KOSOVË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Statut përcaktohen dhe rregullohen çështjet me rëndësi për afarizëm dhe organizimin e punës në Shoqëri, në tekstin e mëtejme, (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), me verzionin e prapashtesës (L.L.C. – Limited Liability Company) emërtimin ligjor » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, KOSOVË, dhe ate:

- I. Emri i Shoqërisë,
- II. Lloji i Shoqërisë,
- III. Firma, selia – adresa, dhe vulat e Shoqërisë,
- IV. Zyrja, degët, (përfaqësitë), dhe njësit e Shoqërisë,
- V. Periudha e themelimit dhe e konstituimit të Shoqërisë,
- VI. Qëllimet dhe veprimtaria e Shoqërisë,
- VII. Themeluesit & Aksionarët e Shoqërisë,
- VIII. Kapitali themelorë, numri, lloji dhe vlera nominale e aksioneve,
- IX. Ndryshimet e kapitalit themelorë,
- X. Të drejtat e aksionarit të Shoqërisë,
- XI. Organet e Shoqërisë,
- XII. Zyra (Selia) dhe Agjenti i Regjistruar,
- XIII. Mbrojtja e ambientit jetësorë,
- XIV. Sekretit afarist,
- XV. Shpërbërja - likuidimi i Shoqërisë,
- XVI. Bashkimi i Shoqërisë,
- XVII. Bashkimi i Shoqërisë me personat e huaj,
- XVIII. Ndryshimet e Statutit të Shoqërisë,
- XIX. Dispozitat kalimtare dhe të fundit.

1. EMRI I SHOQËRISË

Neni 2.

- 2.1 Shoqëria me këtë Statut është themeluar dhe konstituuar si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin: » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, KOSOVË.
- 2.2 Shoqëria afaron dhe në qarkullimin juridik paraqitet me emërtimin e sajë ligjorë, (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, KOSOVË.
- 2.3 Shkurtesa e emërtimit të firmës së Shoqërisë, është: » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, KOSOVË.





Neni 3.

- 3.1 Në qarkullimin juridik me personat e tretë, varësisht nga natyra e marrëveshjes juridike, apo komunikimit, Shoqëria paraqitet me emrin apo shkurtësën e firmës.
- 3.2 Emri dhe shkurtesa e emrit të Shoqërisë, mund të ndryshohen.
- 3.3 Vendimin për ndryshimin e emrit dhe të shkurtësës së emrit të Shoqërisë e marrin themeluesit e Shoqërisë, në Bordin e Aksionarëve të Shoqërisë.

Neni 4.

- 4.1 Shoqëria e ka shenjën e vetë mbrojtëse. Shenja mbrojtëse caktohet me vendim të posaqëm të Bordit të Aksionarëve të Shoqërisë, dhe mund të kërkohet mbrojtja dhe rezervim sajë ligjorë.
- 4.2 Shenja mbrojtëse mund të ndryshohet sipas nevojës, dhe vendimin për ndryshimin e shenjës e marrin themeluesit, në Bordin e Aksionarëve të Shoqërisë.

Neni 5.

- 5.1 Shoqëria në pajtim me ligjin e mbronë emrin e vetë dhe shenjën mbrojtëse, (HOGON).
- 5.2 E drejta në shfrytëzimin e emrit, shkurtësës së emrit dhe të shenjës mbrojtëse, nuk mund të barten në personat të tretë, përveç në rastet e pajtimit paraprak të themeluesve të Shoqërisë, konform me ligjin.

II.- LLOJI I SHOQËRISË

Neni 6.

Shoqëria është person juridik e cila është juridikisht e ndarë dhe e dallueshme nga pronarët. Një interes pronësorë në Shoqëri është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet në Ligjin Për Shoqëritë Tregtare, Nr.02/L-123. Një interes pronësorë mundet, por nuk është e detyrueshme, që të provohet me certifikatë dhe mund të quhet (« aksion »).

III.- FIRMA, SELIA - ADRESA DHE VULAT E SHOQËRISË

Neni 7.

7.1 SELIA E SHOQËRISË DHE ADRESA.

Selia e Shoqërisë është në PRIZREN – RRUGA: MERIMAN JAKUPI, NR.4 PRIZREN. Shoqëria, gjatë egzistimit të sajë, (ushtrimit të veprimtaris), mund t'a ndërrojë vendin e selis së Shoqërisë, në bazë të vendimit të Bordit të Aksionarëve të Shoqërisë.

7.2 VULA E SHOQËRISË.

Shoqëria ka vulën e vetë kryesore zyrëtare.

Me vendimin e Bordit të Aksionarëve të Shoqërisë caktohet dukja dhe forma si dhe përmbajtja e vulës kryesore dhe zyrëtare.

Për përdorimin e vulës përgjegjës është Drejtori i Shoqërisë.

IV.- ZYRJA, DEGËT, (PËRFAQËSITË), DHE NJËSIT E SHOQËRISË

Neni 8.

Në kohën e themelimit të Shoqërisë, Shoqëria nuk ka degë, (përfaqësi) e as njësi. Por me mundësi që gjatë afarizmit në ç'do kohë mund t'i hapë dhe regjistrojë, si në vend ashtu edhe jashtë vendit, konform me legjislacionet e vendeve në të cilat hapet dhe konstituohet.





V.- PERIUDHA E THEMELIMIT DHE E KONSTITUIMIT TË SHOQËRISË.

Neni 9.

Shoqëria, me emërtimin » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, është themeluar dhe konstituuar NË KOHË TË PACAKTUAR.

VI.- QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Neni 10.

10.1 Shoqëria është themeluar me qëllim të realizimit të fitimit dhe zhvillimit të ç'do aktiviteti: (Shërbyes, Tregtar dhe prodhues) të lejuar me ligjet vendore dhe Ndërkombëtare.

10.2 Në sendërtimin e qëllimeve të themelimit, Shoqëria do të afarojë në pajtim me Ligjin dhe rregullat e mira afariste.

10.3 **NË AFARIZMIN E SAJË SHOQËRIA I KRYEN KËTO VEPRIMTARI:**

NR. REN.	NR. KODIT	VEPRIMTARITË - ACTIVITIES
1.	0149	Rritja e kafshëve të tjera
2.	0150	Fermtat e përziera
3.	1083	Përpunimi i çajit dhe kafes
4.	1811	Shtypja e gazetave
5.	1813	Shërbimet e përgatitjeve para-shtypjes dhe para-publikimit
6.	1820	Riprodhimi i mediave të incizuara
7.	4651	Tregtia me shumicë e kompjuterëve, e pajisjeve periferike të kompjuterëve dhe softuerëve
8.	4724	Tregtia me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve prej sheqeri, në dyqane të specializuara
9.	4751	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara
10.	4762	Tregtia me pakicë e gazetave dhe materialit të shkrimit, në dyqane të specializuara
11.	4763	Tregtia me pakicë e incizimeve muzikore dhe videove, në dyqane të specializuara
12.	4939	Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.
13.	4941	Transporti rrugor i mallrave
14.	5010	Transporti detar dhe bregdetar i pasagjerëve
15.	5020	Transporti detar dhe bregdetar i mallrave
16.	5110	Transporti ajror i pasagjerëve
17.	5210	Magazinimi dhe ruajtja
18.	5224	Trajtimi i transportit "cargo"
19.	5229	Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit
20.	5510	Hotelet dhe akomodimi i ngjashëm
21.	5520	Pushimet dhe akomodimet e tjera me qëndrim të shkurtër





NR. REN.	NR. KODIT	VEPRIMTARITË - ACTIVITIES
22.	5530	Kampingjet, parqet me mjete rekreative dhe me rimorkio
23.	5590	Akomodime të tjera
24.	5610	Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit
25.	5621	Furnizimi me ushqim me porosi për raste
26.	5629	Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit
27.	5813	Publikimi i gazetave
28.	5814	Publikimi i revistave dhe periodikëve
29.	5819	Aktivitetet e tjera botuese
30.	5911	Aktivitetet e prodhimit të filmave, videove dhe programeve televizive
31.	5912	Aktivitetet e post-produksionit të filmave, videove dhe programeve televizive
32.	5913	Aktivitetet e shpërndarjes së filmave, videove dhe programeve televizive
33.	5914	Aktivitetet e projektimit të filmit
34.	5920	Incizimi i zërit dhe aktivitetet e publikimit të muzikës
35.	6010	Transmetimi i programeve radiofonike
36.	6020	Aktivitetet e transmetimit të programeve televizive
37.	6110	Aktivitetet e telekomunikimit kabllor
38.	6312	Web portalet
39.	6391	Aktivitetet e agjencive të lajmeve
40.	6399	Shërbimet e tjera të informacionit p.k.t
41.	7830	Sigurimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i funksioneve të burimeve njerëzore
42.	7911	Aktivitetet e agjencive të udhëtimit
43.	7912	Aktivitetet e operatorëve turistikë
44.	7990	Shërbimet e tjera të rezervimit dhe aktivitetet e lidhura me to
45.	8551	Arsimi për sporte dhe rekreacion
46.	8552	Arsimi kulturor
47.	8559	Arsimi tjetër p.k.t.
48.	9001	Shfaqjet artistike
49.	9002	Aktivitetet mbështetëse për shfaqje artistike
50.	9003	Krijimtaria artistike
51.	9004	Funksionimi i objekteve të artit
52.	4690	Tregtia me shumicë jo e specializuar

10.4

Bordi Drejtues i Aksionarëve me vendim të veçantë mund të përcaktohet për zgjerimin e veprimtarisë nga paragrafi 10.3 të këtij neni edhe me aktivitete plotësuese të parapara në NACE REV 2 nga ARBK të MTI- së në Prishtinë.

VII.-

THEMELUESIT & AKSIONARËT E SHOQËRISË



Neni 11.
THEMELUESIT E SHOQËRISË » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, JANË:

(1.)

ONUR VURAL, nga Kocaeli, Karamürsel, Republika e Tyrqisë, i lindur më datën 04.06.1978, në Izmit, nga i ati Ülgen Vural dhe nga e ama Ayşe Muazzez Şenturk, me banim të përhershëm në Adresën: Kayacik Mah. Mavi Körfez Sahil Sitesi B-1 Blok K.6 D.11 Kocaeli, Karamürsel / Türkiye. I pajisur me Pasaportë: U 13310443, e lëshuar nga Autoriteti Shtetëror i Republikës së Tyrqisë, në Karamürsel, më datën 18.10.2016. Shtetas i Republikës së Tyrqisë.

(2.)

EBRU ERDEN, nga nga Kocaeli, Karamürsel, Republika e Tyrqisë, e lindur më datën 25.06.1967, në Kandira, nga i ati Halil Ibrahim Erden dhe e ama Saadet Erden, me banim të përhershëm në Adresën: Kayacik Mah. Turgut Reis Cad. No.12/2 Kocaeli, Karamürsel / Türkiye. E pajisur me Pasaportë: U 13310448, e lëshuar nga Autoriteti Shtetëror i Republikës së Tyrqisë, në Karamürsel, më datën 18.10.2016. Shtetase e Republikës së Tyrqisë.

DHE

(2.)

BILGEHAN RAHMI KÖK, nga Kocaeli, Karamürsel, Republika e Tyrqisë, i lindur më datën 30.03.1993, në Karamürsel, nga i ati Memduh Kök dhe nga e ama Ebru Erden, me banim të përhershëm në Adresën: Kayacik Mah. Turgut Reis Cad. No.12/2 Kocaeli, Karamürsel / Türkiye. E pajisur me Pasaportë: U 13560196, e lëshuar nga Autoriteti Shtetëror i Republikës së Tyrqisë, në Karamürsel, më datën 09.12.2016. Shtetas i Republikës së Tyrqisë.

Neni 12.

- 12.1 Shoqëria mund të ketë për pronarë një ose më shumë persona ose Shoqëri Tregtare.
12.2 Numri i pronarëve - themeluesve të Shoqërisë mund të shtohet ose në të kundërtën të zvogëlohet, konform me nenin 84 të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare, Nr.02/L-123.

Neni 13.

- 13.1 Cilësin e aksionarit të Shoqërisë mund t'a fitojë edhe personi tjetër në bazë të bartjes së aksioneve të Shoqërisë në të, në bazë të trashëgimisë, në bazë të dhurimit të aksioneve, në bazë të bartjes së aksioneve shtesë sipas vendimit mbi rritjen e kapitalit themelues, apo sipas bazës tjetër të caktuar me Ligjin Për Shoqëritë Tregtare, apo me këtë Statut.
13.2 Personi i cili e ka bazën juridike për fitimn e cilësisë së aksionarit të Shoqërisë, me shkrim e informon Bordin Drejtues të Aksionarëve të Shoqërisë dhe e paraqet kërkesën për regjistrim në Librin e aksionarëve, në afat prej tri ditësh. Me kërkesë dërgohet akti apo dëshmia tjetër mbi arritjen e bazës juridike për fitimin e cilësisë së aksionarit të Shoqërisë.





Neni 14.

- 14.1 Bordi i Aksionarëve vendosë lidhur me kërkesën e paraqitur në afat prej pesë (5) ditësh, nëse refuzohet regjistrimi i personit i cili e ka kërkuar regjistrim në Librin e aksionarëve i dërgohet informatë me shkrim duke cekur arsyet e refuzimit të regjistrimit të regjistrimit dhe atë në afatin prej pesë (5) ditësh.
- 14.2 Nëse pranohet kërkesa për regjistrimin e aksionarit-rëve, atëherë bëhet Regjistrimi dhe ndryshohet ky Statut.
- 14.3 Aksionari i rinjë të drejtat e veta i realizon nga data e regjistrimit në Librin e Aksionarëve të Shoqërisë.

VIII.- KAPITALI THEMELORË, NUMRI, LLOJI DHE VLERA NOMINALE E AKSIONEVE

Neni 15.

- 15.1 Shuma e mjeteve themeluese fillestare në të holla të Shoqërisë, është në lartësi prej: 1,000.00 €, dhe me shkronja: (Një mijë euro) të cilat i sigurojnë dhe i deponojnë themeluesit, në pajtim me nenin 79. pika 79.1 të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare, nr.02/L-123.
- 15.2 Shumën e kapitalit themelues, (themeltarë), në tërësi e sigurojnë themeluesit aksionarë, të cilat janë të regjistruara dhe të paguara në të holla.
- 15.3 Shoqëria nuk shtypë aksione në letër me vlerë, por pronësia mbi aksionet regjistrohen në Librin e aksionarëve të Shoqërisë, (aksionet e paçertifikuara), konform me nenin 145. pika 145.4 të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare, Nr.02/L-123.

Neni 16.


- 16.1 Kapitali themeltarë fillestarë i Shoqërisë është i ndarë në aksione të rëndomta në emër. Vlera nominale e një (1) aksioni është 10,00 €, (Dhjetë euro).
- 16.2 Në kapitalin themelues të Shoqërisë marrin pjesë themeluesit-aksionarët, me pjesëmarrje dhe numër të aksioneve, si në përshkrimin tabelarë në vijim:

Nr. Ren.	Emri & Mbiemri i Aksionarit	Pjesëmarrja në: (%)	Nr. i Aksioneve	Vlera e (1) një Aksioni në (€.)	Shuma Totale në (€.)
1.	ONUR VURAL	(84 %)	84	10,00	840,00
2.	EBRU ERDEN	(10 %)	10	10,00	100,00
3.	BILGEHAN RAHMI KÖK	(6 %)	6	10,00	60,00
TOTALI: (1 - 3)		(100 %)	100	10,00	1,000.00

Neni 17.

Me kërkesën e ç'do pronari, Shoqëria mund të lëshojë vërtetim mbi posedimin e aksioneve, sipas gjendjes së fundit të regjistruar në Librin e aksioneve të Shoqërisë.





IX.- NDRYSHIMET E KAPITALIT THEMELORË

Neni 18.

- 18.1 Kapitali themelor, mund të ndryshohet me të gjitha mënyrat dhe modalitetet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi.
- 18.2 Organi kompetent për të vendosur për ndryshimin e kapitalit themelor është Bordi Drejtues i Aksionarëve të Shoqërisë, i cili merr vendime në bazë të Raportit të Drejtorit që përmban treguesit e kërkuar nga ligji.
- 18.3 Në rastin e zmadhimit të kapitalit themelor me para në dorë, aksionari i Shoqërisë, ka një të drejtë parësore në nëshkrimin e tij, proporcionalisht me shumën e aksioneve që ata zotërojnë dhe me përqindjen që i përket në kapitalin e Shoqërisë.
- 18.4 Zmadhimi i kapitalit nëpërmes rritjes nominale të aksioneve bëhet vetëm me pëlqimin e aksionarit, me përjashtim të rastit kur ai realizohet me përfshirjen e rezervave, të fitimeve apo premive të emetimit.

Neni 19.

Shoqëria me rastin e rritjes së kapitalit përmes emetimit të aksioneve shtesë i emitonë aksionet e rregullta në emër apo aksionet me prioritet në emër, e pa të drejtë vote.

X.- TË DREJTAT E AKSIONARIT TË SHOQËRISË

Neni 20.

20.1 AKSIONARËT E SHOQËRISË I KANË KËTO TË DREJTA:

- 20.1.1 Të drejtën në dividendë konform me këtë marrëveshje dhe dispozitat e Ligjit, Nr. 02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare.
- 20.1.2 Të drejtën e shpërndarjes fikse të aksioneve të shoqërisë, nëse fitimi i realizuar nuk shpërndahet në dividendë, por me shumën e fitimit zmadhohet kapitali themeltarë i shoqërisë, e nuk rritet vlera nominale e aksioneve ekzistuese.
- 20.1.3 Të drejtën e lënjes peng të aksioneve me gëzimin e të drejtës në vote apo pa të, varësisht nga marrëveshja e pengut.
- 20.1.4 Të drejtën në vote për ç'do aksion të cilin e ka në pronësi.
- 20.1.5 Të drejtën e shitjes apo të transferit në mënyrë tjetër të aksioneve.
- 20.1.6 Të drejtën në lënjen në trashëgimi të të aksioneve.
- 20.1.7 Të drejtën e pjesëmarrjes në qeverisje me shoqëri sipas këtij Statuti.
- 20.1.8 Të drejtën në informim në lidhje me veprimtarinë dhe afarizmin e Shoqërisë në pajtim me këtë Statut.
- 20.1.9 Të drejtat tjera të caktuara me Ligj dhe me këtë Statut.

Neni 21.

- 21.1 Shoqëria mund t'i lenë peng aksionet e veta në vlerën nominale deri 10% të kapitalit themelues të Shoqërisë.
- 21.2 Kontratën mbi lënjen peng të aksioneve e miraton Bordi Drejtues i Aksionarëve të Shoqërisë.





Neni 22.

- 22.1 Themeluesit aksionet e veta mund t'i bartin në persona të tjerë sipas vlerës nominale apo vlerës tjetër.
- 22.2 Bartja e tërsishme apo e pjesëshme e aksioneve të shoqërisë në person tjetër nuk është e kufizuar.
- 22.3 Mbi transferimin e aksioneve të shoqërisë lidhet kontrata me shkrim me të cilën përcaktohen kushtet e bartjes apo të shitjes së aksioneve.
- 22.4 Aksionari i cili vendos për shitjen e aksioneve, ato duhet t'ia ofrojë në radhë të parë bashkëaksionarit të Shoqërisë, sipas të drejtës së përparësis për blerjen e tyre, dhe nëse ai nuk është i interesuar, atëherë me një pëlqim me shkrim ato mund t'i shiten edhe personave tjerë fizik apo juridik.
- 22.5 Transferimi i aksioneve të Shoqërisë është efektiv ndaj shoqërisë prej momentit të regjistrimit në Librin e aksionarëve të Shoqërisë.

XI.- ORGANET E SHOQËRISË

Neni 23.

- 23.1 **BORDI DREJTUES I AKSIONARËVE**, është organi më i lartë i shoqërisë, të cilin e përbëjnë aksionarët dhe themeluesit e shoqërisë.
- 23.2 **KOMPETENCAT DHE FUSHËVEPRIMI I BORDIT DREJTUES TË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË, ËSHTË:**
 - 23.2.1 Aprovon Statutin e shoqërisë.
 - 23.2.2 Përcakton politikat afariste të shoqërisë.
 - 23.2.3 Aprovon bilancin vjetorë dhe raportet e afarizmit.
 - 23.2.4 Vendos për shpërndarjen e fitimit vjetorë ose të humbjeve eventuale.
 - 23.2.5 Vendos për rritjen e kapitalit themeltarë.
 - 23.2.6 Vendos për ndryshimet statutare, ndërrimin e formës dhe pushimin e punës së shoqërisë.
 - 23.2.7 Vendos për ndryshimin firmës, selisë, dhe të veprimtaris së shoqërisë.
 - 23.2.8 Aprovon rregulloren e vetë të punës.
 - 23.2.9 Vendos për llojin e aksioneve të cilat do të emetohen.
 - 23.2.10 Emron dhe shkarkon drejtorin e shoqërisë.
 - 23.2.11 Zgjedh kryesuesin e Bordit Drejtues të aksionarëve të shoqërisë.
 - 23.2.12 Jepë udhëzime Drejtorit të shoqërisë për realizimin e politikave afariste.
 - 23.2.13 Vendos për bashkëpunim afarist dhe për lidhjen eventuale me kompanitë tjera.
 - 23.2.14 Vendos për çështjet investive.
 - 23.2.15 Vendos për themelimin eventual të njësive, degëve, përfaësive si në vend ashtu edhe në botën e jashtme.
 - 23.2.16 Përcakton kuadrin dhe kushtet e disponimit me mjetet e shoqërisë.
 - 23.2.17 Vendos për çështjet tjera të përcaktuara me Ligj, dhe me Statutin e shoqërisë.

Neni 24.

- 24.1 Bordi Drejtues i Aksionarëve mund të mblidhet me kërkesën e Drejtorit të Shoqërisë.
- 24.2 Mbledhjet e rregullta të Bordit Drejtues të aksionarëve do të përcaktohen me vendimin e Drejtorit, ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme mund të konvokohen nga ana e cilit do aksionarë dhe themelues të Shoqërisë.





DREJTORI I SHOQËRISË » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN

Neni 25.

Drejtori i shoqërisë është organ menaxhues dhe punëdrejtues i shoqërisë. Për Drejtor të Shoqërisë mund të zgjidhet personi-ja (i-e) cili-a i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore nga Bordi i aksionarëve të përpiluara konform me këtë Statutin të shoqërisë, në pajtim me Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212.

Neni 26.

- 26.1 **BORDI DREJTUES I AKSIONARËVE** të shoqërisë në mbledhjen e vetë të mbajtur më DT.19.12.2016, **VENDOSI QË SHOQËRIA TË KETË NJË (1) DREJTOR, SI DHE AGJENTIN E REGJISTRUAR TË SHOQËRISË, SI NË VIJIM:**
- 26.1.1 **DREJTOR I SHOQËRISË » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, ËSHTË:**

ONUR VURAL, nga Kocaeli, Karamürsel, Republika e Tyrqisë, i lindur më datën 04.06.1978, në Izmit, nga i ati Ülgen Vural dhe nga e ama Ayşe Muazzez Şenturk, me banim të përhershëm në Adresën: Kayacik Mah. Mavi Körfez Sahil Sitesi B-1 Blok K.6 D.11 Kocaeli, Karamürsel / Türkiye. I pajisur me Pasaportë: U 13310443, e lëshuar nga Autoriteti Shtetëror i Republikës së Tyrqisë, në Karamürsel, më datën 18.10.2016. Shtetas i Republikës së Tyrqisë.

Neni 27.

Mandati i Drejtorit të shoqërisë është 2 (katër) vjetë, me të drejtë rizgjedhjeje, por jo më shumë se dy here rreshtë, gjersa në rastet e dështimit për realizimin e rezultateve të parapara në bazë të vendimit të Bordit të aksionarëve mund të **SHKARKOHEN** edhe para skadimit të afatit të mandatit të parë.

Neni 28.

DREJTORI I SHOQËRISË KA KËTO KOMPETENCA, PËRQJEGJËSI DHE KUFIZIME:

1. Organizon dhe udhëheqë afarizmin e shoqërisë.
2. Përfaqëson dhe prezenton shoqërinë.
3. Kujdeset për zbatimin e ligjshmërisë në punën e shoqërisë dhe përgjigjet për punën e vetë në bazë të dispozitave valide të ligjeve në Republikën e Kosovës, dhe të rregulloreve interne të shoqërisë.
4. Përgaditë propozimet e vendimeve për mbledhjet e Bordit Drejtues të aksionarëve dhe i zbaton vendimet e aprovuara.
5. Aprovon aktet e përgjithshme ekzekutive të cilat janë kompetenc e tijë.
6. Kujdeset për përgaditjen e bilancit vjetorë dhe i aprovon llogarit periodike.
7. Drejtori i Shoqërisë, ka autorizime të plota, dhe atë: mund të hapë dhe të mbyllë llogari bankare, ka qasje dhe të drejta në tërheqjen e të hollave nga llogaria bankare e Shoqërisë gjer në shumën mujore prej: 2,000.00 € dhe me shkronja (Dymijë euro), për mbulimin e shpenzimeve rrjedhëse të Shoqërisë. Mbi shumën e cekur nevojitet pëlqimi nga Bordi Drejtues i Aksionarëve të Shoqërisë.





8. Drejtori i Shoqërisë ka qasje të palimituar në ndërmarrjen e veprimeve në emër të Shoqërisë, si në vijim: Ka të drejtë që t'i kryej të gjitha transaksionet në emër të llogarisë bankare të Shoqërisë, të bëjë: (deponime, tërheqje të brendshme, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe pagesa të ndryshme), etj., të ngritë dhe të marrë kredi, të nënshkruaj Marrëveshjen e kredisë, e OVD-it, e Letërgarancionit, e Pengut, e Spot kredisë, e Revolving kredisë në emër të kësaj llogarie të Shoqërie, gjer në shumat e lejuara nga Bordi Drejtues i Aksionarëve me vendim. Këtë të drejtë mund ta kenë edhe të autorizuarit e tjerë eventual me prokure, (autorizim).
9. Gjithashtu Drejtori i Shoqërisë ka autorizime të plota në transfere të ndryshme bankare në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
10. Përgaditë raportet dhe dokumentet vjetore financiare për afarizëm dhe për zbatimin e politikës afariste.
11. Propozon shpërndarjen e fitimit.
12. Kryen edhe punët tjera të cilat anë të caktuara me ligj dhe rregulloret interne i dhe nga akti tjetër i përgjithshëm të cilin e aprovon Bordi Drejtues i aksionarëve.

Neni 29.

DREJTORIT TË SHOQËRISË I PUSHONË FUNKSIONI:

1. Me kalimin e afatit për të cilin është zgjedhur.
2. Me dhënjen e dorëheqjes.
3. Me shkarkim nga detyra.
4. Me pushim të punës nga shoqëria.
5. Me paraqitjen e pengesave dhe barrierave të ndryshme për kryerjen e funksionit të Drejtorit të shoqërisë. Drejtori i shoqërisë shkarkohet nga detyra nëse vërtetohet përgjegjësia e tij për rezultate të dobëta afariste.
6. Mosrealizimin konsekuent të politikës afariste të përcaktuar nga Bordi i aksionarëve.
7. Me kryerjen e punëve joligjore dhe afarizmin joligjorë të shoqërisë.
8. Për shkak të keqpërdorimit të kopetencave dhe të autorizimeve.

XII.-

ZYRA (SELIA) DHE AGJENTI I REGJISTRUAR I SHOQËRISË

Neni 30.

30.1

AGJENTE I REGJISTRUAR, I SHOQËRISË, ËSHTË:

ONUR VURAL, nga Kocaeli, Karamürsel, Republika e Tyrqisë, i lindur më datën 04.06.1978, në Izmit, nga i ati Ülgen Vural dhe nga e ama Ayşe Muazzez Şenturk, me banim të përhershëm në Adresën: Kayacik Mah. Mavi Körfez Sahil Sitesi B-1 Blok K.6 D.11 Kocaeli, Karamürsel / Türkiye. I pajisur me Pasaportë: U 13310443, e lëshuar nga Autoriteti Shtetëror i Republikës së Tyrqisë, në Karamürsel, më datën 18.10.2016. Shtetas i Republikës së Tyrqisë.



- 30.2 **AGJENTI I REGJISTRUAR**, i Shoqërisë kompetencat dhe autorizimet do t'i ushtrojë në selin e shoqërisë në adresën **ADRESËN - RRUGA: MERIMAN JAKUPI, NR.4 PRIZREN**, konform me Ligjin, Nr. 02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare.

XIII.- MBROJTJA E AMBIENTIT JETËSORË

Neni 31.

- 31.1 Shoqëria është e obliguar, që në kuadër të veprimtarisë së vetë në tërësi t'iu përmbahet dispozitave të Ligjit Mbi Sigurinë dhe Shëndetin në punë.
- 31.2 Shoqëria është e obliguar që të marrë pjesë aktive në zbatimin e politikave për siguri në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës.

XIV.- SEKRETI AFARIST

Neni 32.

- 32.1 Sekret afarist, konsiderohen shënimet dhe dokumentacioni i caktuar me Ligj ose me vendim të organit kompetent, si dhe shënimet e partnerëve afarist të shoqërisë.
- 32.2 Për ruajtjen e sekretit afarist dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e tij, përgjegjës është Drejtori i shoqërisë.

XV.- SHPËRBERJA - LIKUIDIMI I SHOQËRISË.

Neni 33.

- 33.1 **SHOQËRIA DO TË SHPËRBEREHET, NË KËTO RASTE:**
- 33.2 Vendimit të pronarëve për shpërbërje.
- 33.3 Pranimit të një urdhëri të gjykatës me të cilin kërkohet përfundimi i ekzistencës së shoqërisë, dhe atë: (nëse koha për ankim në këtë urdhër ka skaduar, dhe nuk është ushtruar ankesa në pritje për shqyrtim nga ndonjë Gjykatë e nivelit më të lartë).
- 33.4 Nëse shpërbërja e shoqërisë bëhet sipas paragrafit 33.2 të këtij neni, kemi të bëjmë me (shpërbërje vullnetare), meqë rast veprimtaria përmbillet dhe asetet likuidohen konform me dispozitat e Ligjit, Nr.02/L-123. Për Shoqëritë Tregtare.
- 33.5 Nëse shpërbërja e shoqërisë bëhet sipas paragrafit 33.3 të këtij neni, dhe Shoqëria nuk është e falimentuar, gjykata do të mbikëqyrë përmbylljen e veprimtarisë dhe likuidimin sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin Për Shoqëritë Tregtare, Nr.02/L-123, ose procedurave tjera të përcaktuara nga gjykata.
- 33.6 Nëse shpërbërja e shoqërisë bëhet sipas paragrafit 33.3 të këtij neni, gjykata zbaton dhe rrespekton dispozitat e ligjeve për falimentim që rregullojnë përmbylljen e veprimtarisë dhe likuidimin e Shoqërisë.
- 33.7 Për zbatimin e procedurave të shpërbërjes dhe likuidimit të Shoqërisë, do të zbatohen dispozitat e Ligjit Për Shoqëritë Tregtare, Nr.02/L-123.

XVI.- BASHKIMI I SHOQËRISË





Neni 34.

- 34.1 Sipas planit për bashkim që është në pajtim me nenin 121 të Ligjit, Nr.02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare, një ose më shumë shoqëri mund të bashkohen në një kompani të themeluar konform me ligjin e përmendur. Për këtë qëllim (« bashkimi ») do të thotë një transakcion në të cilin një ose më shumë kompani, dhe atë:
- 34.1.1 Kompanitë bashkohen dhe i bartin tërë asetet dhe detyrimet e tyre në njerën prej këtyre kompanive, dhe
- 34.1.2 Kompanitë bashkohen dhe i bartin tërë detyrimet e tyre në një kompani të re të themeluar, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 124 të Ligjit, Nr.02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare.

Neni 35.

Plani për bashkim duhet të përmbajë të gjitha elementet dhe kushtet nga neni 121 të Ligjit, Nr.02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare.

Neni 36.

Në rastin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, e cila është palë në bashkim, Plani për bashkim duhet të miratohet nga të gjithë pronarët, konform me nenin 107 të Ligjit, Nr. 02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare.

Neni 37.

- 37.1 Pas përfundimit të bashkimit, të gjitha palët në bashkim duhet që në Zyren e Regjistrimit ta prezantojnë Planin për Bashkim, nëse plani është përpiluar konform me kushtet e parapara në nenin 121 të Ligjit, Nr.02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare.
- 37.2 Pas hyrjes në fuqi të bashkimit kompanitë të cilat janë pale në bashkim, shëndrohen në një kompani të vetme e cila në Planin për Bashkim do të quhet shoqëria e mbijetuar, dhe ekzistimi i veçanët juridik i të gjitha kompanive të tjera, përveq kompanis së mbijetuar, do të përfundojë.
- 37.3 Kompania e mbijetuar është përgjegjëse për të gjitha detyrimet, të çfardo lloji, të secilës kompani në bashkim, dhe fiton të gjitha të drejtat dhe intereset në të gjitha asetet, e çfardo lloji, të secilës kompani në bashkim.
- 37.4 Kompania e mbijetuar zëvendëson të gjitha kompanitë e tjera të bashkuara, ekzistenca e të cilave është përfunduar me bashkim.

XVII.- BASHKIMI I SHOQËRISË ME PERSONAT E HUAJ JURIDIK

Neni 38.

Një ose më shumë persona të huaj juridik dhe një ose më shumë shoqëri mund të bashkohen, dhe se kompania e mbijetuar duhet t'i zbatojë të gjitha dispozitat e Ligjit të zbatueshëm në Kosovë, si dhe dispozitat e zbatueshme nga nenet 37 dhe 38 të Ligjit, Nr.02/L-123 Për Shoqëritë tregtare.

XVIII.- NDRYSHIMET E STATUTIT





Neni 39.

- 39.1 Ky Statut mund të ndryshohet dhe plotësohet, në ç'do rast kur konstatohet se nuk është i harmonizuar me ligjin në fuqi, dhe kur të konsiderohet se mënyra e rregullimit të çështjeve të caktuara, nuk është në pajtim me interesat e Shoqërisë dhe paraqetë pengesë për afarizmin e Shoqërisë në tërësi.
- 39.2 Ndryshimet dhe plotësimet e statutit kryhen nga Bordi i aksionarëve të shoqërisë, me Aneks mbi ndryshimet dhe plotësimet, sipas iniciativës së tijë, si dhe punonjësve profesional.
- 39.3 Ky Statut nxirret në procedurën e përcaktuar me ligjë, dhe me dispozitat e këtij Statuti mbi nxjerrjen e akteve të përgjithshme në shoqëri.

XIX.- DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 40.

- 40.1 Ky Statut hyn në fuqi ditë e miratimit dhe të nënshkrimit nga themeluesit e shoqërisë.
- 40.2 Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë rregulluar me këtë Statut, do të aplikohen automatikisht dispozitat e Ligjit Për Shoqëritë Tregtare, Nr.02/L-123, si dhe të dispozitave të Ligjit, nr.04/L-006 Për ndryshmin dhe plotësimin e Ligjit bazik Për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, dhe do të vulozet me vulën zyrtare të shoqërisë pas regjistrimit në ARBK të MTI-së në Prishtinë.



**THEMELUESIT DHE AKSIONARËT E SHOQËRISË
» NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, KOSOVË**

1. ONUR VURAL _____

(Nënshkrimi - Signature)

2. EBRU ERDEN _____

(Nënshkrimi - Signature)

3. BILGEHAN RAHIM KÖK _____

(Nënshkrimi - Signature)





REPUBLIKA E KOSOVËS
NOTER
Learte F. Cana

LRP.nr. 0441/2019

VËRTETIM I KOPJES SË DOKUMENTIT ORIGINAL

Me datë 22.02.2019 (Njëzetë e Dy Shkurt Dymijë e Nëntëmbëdhjetë), para meje i nënshkruari më poshtë, Noter Learte F. Cana, në Prishtinë, Rr. "Luan Haradinaj", Nr. 29, H4, K.1, Nr. 4,- Prishtinë, është paraqitur: -----

ONUR VURAL, i lindur me date **04.06.1978** (Katër Qershor Njëmijë e Nëntëqind e Shtatëdhjetë e Tetë) në Izmit Turqi, me vendbanim Prizren me pasaportë me numër **U15332857** dhe me numër personal **34480897294** lëshuar nga MPB Republika e Turqisë me datë skadimi **14.11.2027**.-----

"NEO & QUALITY" L.L.C PRIZREN – STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA – NR- 810975633, DATË 19.12.2016, ONUR VURAL (x1, 14 fq.).-----

Noteri vërteton se dokumenti është sjellë dhe prezantuar nga pala e lartpërmendur.-----

Dokumenti për vërtetim është prezantuar në **original** është e shkruar në **gjuhën shqipe**, dhe se kopja e vërtetuar përputhet në çdo aspekt me dokumentin original, përfshirë këtu shkrimin, pikësimin dhe shkurtesat e fjalëve.-----

Dokumenti original nuk përmban asnjë ndryshim, pjesë të fshirë, shënjim me vija, shtesa në tekst. Dokumenti original nuk është i grisur, nuk është i dëmtuar apo nuk duket i dyshimtë në pamjen e tij apo në ndonjë mënyrë apo formë tjetër.-----

Noteri e njoftoi palën e lartpërmendur që e ka prezantuar këtë dokument, për përgjegjësinë penale të vetë palës në rast të prezantimit të dokumentit të falsifikuar.-----

Ky vërtetim lëshohet në kuptim të nenit 47 të Ligjit të Noterisë ndërsa shpenzimet u llogaritën në shumë prej 1 € për 1 faqe, plus 18% TVSH (Udhëzimi Administrativ për Tarifat e Përkohshme Noteriale, neni 27).-----



APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)

1. Shteti/Drzava/Conutry: REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

Ky dokument publik / Ova javni dokument / This public document

2. Është firmosur nga/je potpisan od strane /has been signed by: L. CANA

3. i cili vepron në cilësinë e/koji deluje u svojstvu/acting in the capacity of: NOTER

4. dhe mban vulën/pulën/i zadržu pečat/markicu/bears the seal/stamp of: O.N.K

Vërtetohet / Potvrđuje se / Certified

5. në/uzar: PRISHTINË 6. datë / datum / date: 22.02.2019

7. nga/od/by: DSK/HPD

8. në/uzar: 008646/19

9. vula/pulla / pečat/markica/seal/stamp

10. nënshkrimi/potpis/signature:



» NEO & QUALITY « L.L.C.
NRB.71344681
NRF. 601722053
Rr. Meriman Jakupi, Nr.4
DT. 18.12.2017
P r i z r e n .



Themeluesit në largim në Bordin Drejtues të aksionarëve të Shoqërisë me emërtimin ligjor » NEO & QUALITY « L.L.C., në tekstin e mëtejshëm: (Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar), me NRB. 71344681 dhe NRF. 601722053, e regjistruar në ARBK. të MTI-së në Prishtinë, më datën 22.12.2016, me seli në Prizren, rruga: Meriman Jakup, Nr.4 Prizren. Në prezencën aktive të themeluesit dhe aksionares së re të Shoqërisë, z. ZEYNEP NESLIHAN VURAL, nga Kocaeli, Karamürsel, Republika e Tyrqisë. Duke u bazuar në dispozitat e nenit 39 paragrafi 39.2 të Statutit të Shoqërisë, aprovuar më datën 19.12.2016. Më datën 18.12.2017, unanimisht u muarr dhe u aprovue ky:

ANEKS STATUT №2/2017
PËR NDRSHIMET DHE PLOTËSIMET E STATUTIT TË SHOQËRISË
» NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN

Me këtë ANEKS STATUT №2 NDRYSHOHEN DHE PLOTËSOHEN dispozitat e nenit 11 Kreu VII (Themeluesit dhe Aksionarët e Shoqërisë), dispozita e nenit 16 Kreu VIII (Kapitali Themelorë, Numri, Lloji dhe Vlera Nominale e Aksioneve), të Statutit të Shoqërisë me emërtimin tregtarë dhe ligjorë » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, aprovuar më datën 19.12.2016, si në vijim:

Neni 1.

- 1.2 **NDRYSHOHET dhe PLOTËSOHET** dispozita e nenit 11 Kreu VII (Themeluesit dhe Aksionarët e Shoqërisë), në Statutin e Shoqërisë » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, ashtu që dispozita e nenit të lartë cekur do të ketë përmbajtje si në vijim:
- 1.2.1 Pas tërheqjes dhe largimit definitive nga Shoqëria e z. **EBRU ERDEN**, nga Rep. e Tyrqisë, aksionare e pjesë prej: 10 % të aksioneve në Shoqësi, dhe z. **BILGEHAN RAHMI KÖK**, nga Rep. e Tyrqisë, aksionar i pjesës prej 6% të aksioneve në Shoqëri, të cilin sipas autorizimit të noterizuar: 006973 – Vula Ftohtë, datë 02.08.2017 në Karmürsel/Kocaeli, Rep. e Tyrqisë, e përfaqëson dhe e nënshkruan, z. EBRU ERDEN, nga Karamürsel, Kocaeli, Republika e Tyrqisë. Me kalimin e pronësisë së aksioneve të bartura mbi bazën e Kontratave të lidhura për shitë-blerjen e aksioneve, nga aksionarja e re e Shoqërisë, z. **ZEYNEP NESLIHAN VURAL**, shtetase e Rep. së Tyrqisë.
- 1.2.2 **THEMELUES dhe AKSIONARË** të Shoqërisë » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, JANË:

(1.)

ONUR VURAL, nga Kocaeli, Karamürsel, Republika e Tyrqisë, i lindur më datën 04.06.1978, në Izmit, nga i ati Ülgen Vural dhe nga e ama Ayşe Muazzez Şentürk, me banim të përhershëm në Adresën: Kayacik Mah. Mavi Körfez Sahil Sitesi B -1 Blok K.6 D.11 Kocaeli, Karamürsel / Türkiye. I pajisur me Pasaportë: U 15332857, e lëshuar nga Autoriteti Shtetëror i Republikës së Tyrqisë, në Karamürsel, më datën 15.11.2017, valid gjer më datën 14.11.2027. Shtetas i Republikës së Tyrqisë.

DHE

OV
NU

J.E.



(2.)

ZEYNEP NESLIHAN VURAL, nga Kocaeli, Karamürsel, Republika e Tyrqisë, e lindur më datën 24.03.1962, në Istanbul, nga i ati Hüseyin Nejat dhe nga e ama Huriye Saynur, me banim të përhershëm në Adresën: Kayacik Mah. Mavi Körfez Sahil Sitesi B -1 Blok K. 6 D.11 Kocaeli, Karamürsel / Türkiye. E pajisur me Pasaportë: U 15290365, e lëshuar nga Autoriteti Shtetëror i Republikës së Tyrqisë, në T.C. Prizren BK., më datën 15.11.2017. Shtetase e Republikës së Tyrqisë.

Neni 2.

- 2.2 **NDRYSHOHET dhe PLOTËSOHET** dispozita e nenit 16 Kreu VIII (Kapitali Themelorë, Numri, Lloji dhe Vlera Nominale e Aksioneve) në Statutin e Shoqërisë me emërtimin » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, ashtu që dispozita e nenit të lartë cekur do të ketë përmbajtje si në vijim:
- 2.2.1 Me ndryshimet sin ë nenin 1 paragrafi 1.1 nënparagrafi 1.1.1 të këtij vendimi. Kapitali themeltarë fillestarë i Shoqërisë është i ndarë në aksione të rëndomta në emër. Vlera nominale e një (1) aksioni mbetet e pandryshaur 10,00 €, (Dhjetë euro).
- 2.1.2 Në kapitalin themelues të Shoqërisë marrin pjesë themeluesit-aksionarët, me pjesëmarrje dhe numër të aksioneve, si në **PËRSHKRIMIN TABELAR, NË VIJIM:**

Nr.	Emri & Mbiemri i Aksionarit	Pjesëmarrja në: (%)	Nr. i Aksioneve	Vlera e (1) një Aksioni në (€.)	Shuma Totale në (€.)
1.	ONUR VURAL	(84 %)	84	10,00	840,00
2.	ZEYNEP NESLIHAN VURAL	(16 %)	16	10,00	160,00
TOTALI: (1)		(100 %)	100	10,00	1,000.00

Neni 3.

- 3.1 Të gjitha dispozitat tjera të Statutit të Shoqërisë » NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN, aprovuar më datën 19.12.2016, mbesin në fuqi dhe vazhdojn të prodhojnë efekte juridike.
- 3.2 Ky ANEKS STATUR N2, hyn në fuqi ditën e miratimit dhe të nënshkrimit nga Themeluesit e Shoqërisë.

**THEMELUESIT DHE AKSIONARËT E SHOQËRISË
» NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN**

1. ONUR VURAL



(Nënshkrimi – Signature)

2. EBRU ERDEN



(Nënshkrimi – Signature)



20

3. BILGEHAN RAHIM KÖK

Ebru Erden

(Nënshkrimi - Signature)

(Nënshkrimi i të autorizuarës z. EBRU ERDEN, sipas
Autorizimit të noterizuar: 006973 – Vula Ftohtë, datë
02.08.2017 në Karmursel/Kocaeli, Rep. e Turqisë, e përfaqëson
dhe e nënshkruan, z. Ebru ERDEN, nga Karamürsel, Kocaeli,
Republika e Tyrqisë.

**THEMELUESJA DHE AKSIONARJA E RE E SHOQËRISË
» NEO & QUALITY « L.L.C. PRIZREN
ZEYNEP NESLIHAN VURAL**

Zeynep Neslihan Vural

(Nënshkrimi - Signature)



OV

EIE.

VËRTETIMI NËN SHKRIMIT

Unë, Aliriza Beshi, noter në Prizren, rruga Ibrahim Lutfiu nr.50, vërtetohet se në dokumentin "ANEKS STATUT NR.2/2017", para meje kane nënshkruar personalisht me dorë te vetë;

Onur (Ülgen) Vural, i lindur më 04.06.1978 (katër qershor njëmijë e nentëqind e shtatëdhjetë e tetë) në IZMIT-TURQI, shtetas Turk, identiteti i të cilit u konstatua nga TUR Pass me nr.U 15332857, lëshuar nga organet kompetente turke, vlefshëm deri me dt.14.Nentor 2027, me banim në Prizren, rr.Suzi Qelebi nr.61, dhe në Kocaeli, Karamursel-Turqi;

Ebru (Halil Ibrahim) Erden, i lindur më 25.06.1967 (njëzet e pesë qershor njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) në KANDIRA-TURQI, shtetas Turk, identiteti i të cilit u konstatua nga TUR Pass me nr.U 15332854, lëshuar nga organet kompetente turke, vlefshëm deri me dt.14.Nentor 2027, me banim në Prizren, rr.William Wolker nr.6 kati 3 dhe në Kocaeli, Karamursel-Turqi .

-Ebru (Halil Ibrahim) Erden, i lindur më 25.Qershor 1967 , në KANDIRA-TURQI, shtetas Turk, identiteti i të cilit u konstatua nga TUR Pass.nr.U 15332854, lëshuar nga organet kompetente turke, vlefshëm deri me dt.14.Nentor 2027, me banim në Prizren, rr.William Wolker nr.6 kati 3 dhe në Kocaeli, Karamursel-Turqi si pronare e biznesit "NEO& QUALITY" L.L.C,me seli në Prizren,rr.Meriman Jakupi nr.4, me NRB 71344681, aktive, si e autorizuar e pronares e **Bilgehan Rahmi (Memduh Kök) Kök** me TUR Pass me nr.U 13560196 si dhe shenimet e tjera ne autorizimin nr.006973 dhe dt.02.Gusht 2017, i vërtetuar para noteres në Karamursel, Yilmaz Şişman dhe

Zeynep Neslihan (Huseyin Nejat) Vural, e lindur me 24.03.1962 (njëzet e katër mars njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) në ISTANBUL-TURQI, shtetase Turk, identiteti i së ciles u konstatua nga TUR Pass me nr.U 15290365, lëshuar nga organet kompetente turke, vlefshëm deri me dt.14.Nentor 2027, me banim në Prizren, rr.Suzi Qelebi nr.61 dhe në Kocaeli, Karamursel-Turqi .

Noteri vërtetohet se ky nënshkrim është i vërtetë. Pala gëzon ushtrimin e të drejtave të tyre të veprimit.

Firmosja e dokumentit është bërë konform nenit 44 të Ligjit për Noterinë e Kosovës.

Pjesëmarrësit janë të njohtuar se noteri nuk është përgjegjës lidhur me përmbajtjen e dokumentit shkresës e as që është i obliguar t'i merr në pyetje pjesëmarrësit a janë të autorizuar për këtë çështje (në prill 2017)

Dokumenti ka tre faqe dhe tre fletë dhe vërtetohet në 3.(dy) ekzemplarë.

Pagesa noterale për vërtetimin në bazë nenit 16. LNK dhe të nenit 29. të UA nr.02 /12

Ky vlloganitur në vlerë /faqe 36.00 € + 6.48€tosh.

